



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
MINISTRI

Nr. 2436 / prot.  
2

Tiranë, më 12.12.2022

**UDHËZIM**

Nr. 6, datë 12.12.2022

**PËR**

**PROCEDURAT E DHËNIES SË NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE NË  
ZBATIM TË NENIT 30, TË LIGJIT NR. 9210, DATË 23.03.2004 “PËR STATUSIN E  
USHTARAKUT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të ndryshuar; shkronjës “f”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 30, të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

**U DHE Z O J:**

1. Për dhënie të ndihmës së menjëhershme financiare në rast të sëmundjeve të rënda e të gjata të ndiqet procedura, si më poshtë:
  - 1.1. Sëmundje të rënda, në kuptim të nenit 30, të ligjit 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, do të konsiderohen sëmundjet e listuara më poshtë, sipas grupeve kur kanë shkaktuar paaftësi në punë mbi 7 ditë qëndrimi në spital, të justifikuar nga institucioni mjekësor spitalor ku është kryer trajtimi mjekësor, janë të rrezikshme për jetën dhe kanë ndikim negativ në cilësinë dhe mirëfunksionimin e përditshëm të organizmit për të cilën kërkohet një periudhë e gjatë trajtimi mjekësor.

**1.2.** Sëmundje të gjata, në kuqtim të nenit 30, të ligjit 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, do të konsiderohen ato sëmundje kronike të listuara më poshtë sipas grupeve, të cilat kanë shkaktuar paaftësi në punë mbi 5 ditë rresht brenda vitit kalendarik, në të cilin është paraqitur kërkesa për ndihmë të menjëherëshme financiare ose brenda 90 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkeshës.

#### **Grupi A**

- a) Sëmundje tumorale malinje;
- b) Sëmundje të rënda që shoqërohen me humbje definitive të funksionit të organeve;
- c) Politraumat dhe/ose trauma që shkaktojnë paaftësi fizike/organore;
- ç) Kirurgji e hapur torakale dhe e kokës.

#### **Grupi B**

- a) Sëmundjet e rënda neurologjike (aksidentet cerebro-vaskulare, polineuropatitë);
- b) Tromboembolitë organore;
- c) Sëmundje të lindura që kërkojnë trajtim të përhershëm mjekësor dhe/ose psiko-social për familjarët;
- ç) Sëmundje të rënda që shoqërohen me alterim të funksionit të organeve dhe trajtohen me ndërhyrje kirurgjike madhore.

#### **Grupi C**

- a) Sëmundje kronike që shoqërohen me komplikacione dhe kërkojnë trajtim të përhershëm konservativ;
- b) Komplikacione të shtatzënise që rrezikojnë jetën e nënës dhe/ose fetusit që kërkojnë ndërhyrje urgjente kirurgjike;
- c) Çrregullimet psikologjike post traumatike.

#### **Grupi D**

- a) Sëmundje të rënda që shoqërohen me dëmtim të funksionalitetit të organeve dhe trajtohen me angioplastikë, ndërhyrje endoskopike;
- b) Frakturna me kohë të gjatë rehabilitimi.

#### **Grupi E**

- a) Sëmundje tumorale beninje;
- b) Sëmundje kronike dermatologjike të gjeneralizuara;
- c) Sëmundjet ORL-maxillofaciale të trajtuara me kirurgji;
- ç) Ndërhyrje kirurgjike komune (apendicit akut, kolecistektomi tipike, herniet abdominale, herniet inguinale, lithotripsi, katarakt, trajtim me laser etj.).

## **Grupi F**

- a) Sëmundje akute/kronike të sistemeve dhe organeve, pa komplikacione, që trajtohen në mënyrë konservative;
- b) Sëmundjet infektive që kërkojnë hospitalizim.

**1.3.** Në rast sëmundjeje të rëndë e të gjatë të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë apo të një pjesëtari të familjes në ngarkim të tij, ushtaraku paraqet në komandën, repartin, strukturën e varësisë së MM/SHPFA-së apo drejtorinë e MM/SHPFA-së ku shërben, dokumentacionin e mëposhtëm:

**1.3.1. Për trajtimin që kryhet në institucionet shëndetësore publike e private brenda vendit:**

- a) kërkesë personale në strukturën përkatëse (drejtorinë e MM/SHP-së, komandën, repartin, strukturën e varësisë së MM/SHP-së), ku ushtaraku shërben sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b) certifikatë familjare në rast të sëmundjes së një pjesëtari të familjes në ngarkim të tij;
- c) fletëdalje/fletëpërmbledhje e daljes/epikrizë dalje e institucionit shëndetësor ku është trajtuar, i firmosur nga mjeku kurues, shefi i shërbimit, si dhe të ketë vulën e institucionit;
- ç) vërtetim i shërbimit të statistikës të institucionit shëndetësor ku është trajtuar, që konfirmon shtrimin dhe kohëzgjatjen e qëndrimit në spital;
- d) prononcimi i shefit të shëndetësisë (në mungesë: prononcim i specialistit të shëndetësisë/mjek) të komandës, strukturës së varësisë MM/SHPFA-së;
- dh) urdhri i MM-së, kur është trajtuar sipas VKM nr. 269, datë 28.4.2005 “Për kriteret dhe masën e mbulimit financiar të kujdesit shëndetësor për ushtarakun e Forcave të Armatosura”, i ndryshuar;
- e) fotokopje e kartës së identitetit.

**1.3.2. Për trajtimin që kryhet në institucionet shëndetësore publike e private jashtë vendit:**

- a) kërkesë personale në strukturën përkatëse (drejtorinë e MM/SHP-së, komandën, repartin, strukturën e varësisë së MM/SHP-së), ku ushtaraku shërben sipas formularit nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b) certifikatë familjare në rast të sëmundjes së një pjesëtari të familjes në ngarkim të tij;
- c) Fletëdalje/fletëpërmbledhje e daljes/epikrizë dalje e institucionit shëndetësor ku është trajtuar, i firmosur nga mjeku kurues, të ketë vulën e institucionit dhe të jetë i përkthyer dhe i noterizuar;
- ç) prononcimi i shefit të shëndetësisë (në mungesë: prononcim i specialistit të shëndetësisë/mjek) të komandës, strukturës së varësisë MM/SHPFA-së;

- dh) urdhri i MM-së, kur është trajtuar sipas VKM nr. 269, datë 28.4.2005 “Për kriteret dhe masën e mbulimit financiar të kujdesit shëndetësor për ushtarakun e Forcave të Armatosura”, i ndryshuar;
- d) fotokopje e kartës së identitetit.

**1.4. Për trajtimin e sëmundjeve që ndiqen ambulatorisht në institucionet shëndetësore publike brenda vendit:**

- a) kërkesë personale në strukturën përkatëse (drejtorinë e MM/SHP-së, komandën, repartin, strukturën e varësisë së MM/SHP-së), ku ushtaraku shërben sipas formularit nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b) certifikatë familjare në rast të sëmundjes së një pjesëtarit të familjes në ngarkim të tij;
- c) relacion mjekësor nga mjeku i familjes në qendrën shëndetësore ku ndiqet që konfirmon sëmundjen sipas kartelës shëndetësore, i firmosur nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist që e ndjek. Ky relacion të ketë vulën e institucionit;
- ç) prononcimi i shefit të shëndetësisë (në mungesë: prononcim i specialistit të shëndetësisë/mjek) të komandës, strukturës së varësisë MM/SHPFA;
- d) urdhri i MM-së, kur është trajtuar sipas VKM nr. 269, datë 28.4.2005 “Për kriteret dhe masën e mbulimit financiar të kujdesit shëndetësor për ushtarakun e Forcave të Armatosura”, i ndryshuar;
- dh) fotokopje e kartës identitetit.

**1.5. Propozimi i dhënies së ndihmës së menjëherëshme financiare për çdo ushtarak të Forcave të Armatosura apo pjesëtar të familjes në ngarkim të tij/saj, bëhet vetëm një herë në rast sëmundjesh kronike, të cilat mund të përsëriten me intensitet, kohë e komplikacione të ndryshme, sipas listës së përcaktuar në pikën 1 të këtij udhëzimi.**

**1.6. Kur ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura (oficer, nënëficer, ushtar) pëson sëmundje të rëndë e të gjatë, përfiton ndihmë të menjëherëshme financiare, në përputhje me llojin e sëmundjes së kategorizuar sipas grupeve dhe në përpjesëtim të drejtë me trajimin mjekësor të përfstuar dhe dëmin e shkaktuar sipas klasifikimit të mëposhtëm:**

- **Grupi A** - nga 4 deri në 6 paga mujore;
- **Grupi B** - nga 2 deri në 3 paga mujore;
- **Grupi C** - 2 paga mujore;
- **Grupi D** - nga 1 deri në 2 paga mujore;
- **Grupi E/F** - 1 pagë mujore.

**1.7. Kur ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura i pëson sëmundje të rëndë e të gjatë, bashkëshorti/ja, fëmijë, në ngarkim të tij/saj, ai përfiton ndihmë të menjëherëshme financiare sipas klasifikimit të mëposhtëm:**

- **Grupi A/B** - nga 1 deri në 2 paga mujore;
- **Grupi C/D** - 1 pagë mujore;
- **Grupi E/F** - 1/2 pagë mujore.

**1.8.** Kur ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura i pëson sëmundje të rëndë e të gjatë një anëtar tjetër i familjes në ngarkim të tij, që nuk përfshihet në pikën 1.7, ai përfiton ndihmë të menjëherëshme financiare në masën **1/2 pagë mujore**.

**1.9.** Në rastet kur ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura, për shkak të sëmundjes së rëndë e të gjatë të tij, ka përfituar mbulim financiar për shpenzimet e diagnostikimit apo kurimit, sipas VKM nr. 269, datë 28.04.2005 “Për kriteret dhe masën e mbulimit financiar të kujdesit shëndetësor për ushtarakun e Forcave të Armatosura”, i ndryshuar, përfiton ndihmë të menjëherëshme financiare në masën **1/2 pagë mujore**.

**1.10.** Kur të dy dy prindërit janë ushtarakë aktivë të Forcave të Armatosura, ndihmën e menjëherëshme financiare për rastet e përcaktuara në pikën 1.7 dhe 1.8, e përfiton vetëm njëri prej tyre.

**2. Për dhënien e ndihmës së menjëherëshme financiare në rast vdekje të ndiqet procedura, si më poshtë:**

**2.1.** Në rastet kur ushtaraku aktiv (oficer, nënoficer, ushtar) vdes, propozimi për dhënie ndihmë të menjëherëshme financiare familjes së tij, i bëhet nga eprori direkt i ushtarakut në masën **4 (katër) paga mujore**.

**2.2.** Eprori direkt i ushtarakut, së bashku me propozimin, dërgon këto dokumente:

- a) certifikatë e gjendjes familjare në momentin e ndodhjes së ngjarjes;
- b) certifikatë vdekje;
- c) certifikatë e gjendjes familjare pas vdekjes së ushtarakut;
- ç) fotokopje e kartës së identitetit;

**2.3.** Dokumentacioni përkatës paraqitet në komandën apo drejtorinë ku ka shërbyer për herë të fundit ushtaraku, nga një pjesëtar i familjes së tij. Eprori direkt i ushtarakut është i detyruar të njoftojë brenda 10 ditësh pune një anëtar të familjes së të ndjerit për iniciimin e praktikës dhe plotësimin e dokumentacionit.

Pagesa e ndihmës së menjëherëshme financiare të bëhet për familjen e të ndjerit.

**2.4.** Në rastet kur ushtarakut aktiv i vdes bashkëshorti/ja/fëmijë në ngarkim të tij, përfiton ndihmë të menjëherëshme financiare në masën **2 paga mujore**, ndërsa në rastet kur i vdes një prej familjarëve të tjerë në ngarkim të tij, përfiton **1 pagë mujore**.

**2.5.** Në rastet kur ushtarakut aktiv i vdes një familjar në ngarkim të tij, ai paraqet në komandë, repart, strukturën e varësisë së MM/SHPFA-së, ku shërben, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesë personale në strukturën përkatëse (drejtorinë e MM/SHP-së, komandën, repartin, strukturën e varësisë së MM/SHP-së), ku ushtaraku shërben sipas formularit nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

- b) certifikatë të gjendjes familjare në momentin e ndodhjes së ngjarjes;
- c) certifikatë vdekjeje;
- ç) certifikatë të gjendjes familjare pas vdekjes së personit;
- d) fotokopje e kartës së identitetit.

**3. Për dhënien e ndihmës së menjëherëshme financiare në rast të dëmtimeve të mëdha të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore të ndiqet procedura, si më poshtë:**

**3.1.** Ushtaraku aktiv, në rast të dëmtimeve të mëdha të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, përfiton ndihmë të menjëherëshme financiare në masën deri në **3 paga mujore**, sipas vlerësimit të bërë nga institucionet përkatëse.

**3.2.** Masa e dhënies së ndihmës së menjëherëshme financiare, në rast fatkeqësie natyrore, të jetë e përshkallëzuar **nga 1 pagë deri në 3 paga**, sipas llojit të dëmit të shkaktuar e të vlerësuar sipas dokumentacionit të shkronjës “ç”, të pikës 3.3.

**3.3.** Në rast të dëmtimeve të mëdha të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, ushtaraku paraqet në komandën, repartin, strukturën e varësisë së MM/SHPFA-së apo drejtorinë e MM/SHPFA-së ku shërben, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesë personale në strukturën përkatëse (drejtorinë e MM/SHP-së, komandën, repartin, strukturën e varësisë së MM/SHP-së), ku ushtaraku shërben sipas formularit nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b) certifikatë pronësie, kontratë porosie, dëshmi legalizimi ose çdo dokument tjetër provues që vërteton të drejta reale pronësie mbi pronën e dëmtuar;
- c) procesverbal ose aktkonstatimi nga organet e qeverisjes qendrore ose vendore, të cilat kanë kompetencë sipas ligjit për konstatimin e gjendjes;
- ç) preventivat ose vërtetimet e dëmeve nga ana ndërtimore e pronës së ushtarakut, hartuar nga organet e qeverisjes qendrore, vendore ose këshilli i qarkut ku ka ndodhur dëmi.
- d) aktekspertizë nga PMNZSH-ja, në raste zjarri;
- dh) certifikatë familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë natyrore;
- ë) fotokopje e kartës identitetit.

**4.** Dokumentacioni i përcaktuar në këtë udhëzim, në çdo rast duhet të jetë original ose fotokopje e noterizuar, përvèç urdhrit të ministrit të Mbrojtjes. Dokumentacioni i cili mban vulën dhe nënshkrimin elektronik, për efekt të këtij udhëzimi, do të ketë vlerën e dokumentit original.

**5.** Dokumentacioni i pikave 1, 2 dhe 3 të këtij udhëzimi, të paraqitet nga ushtaraku në strukturën përkatëse, jo më vonë se **3 muaj** nga data e daljes nga spitali, lëshimi i vërtetimit të shërbimit ambulator, i vdekjes apo i dëmtimit të pronës.

**6.** Komandanti i strukturës ose drejtori i drejtorisë brenda një afati kohor prej 10 ditësh pune, dërgon për procedura të mëtejshme në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse

7. (DPESHM), në Ministrinë e Mbrojtjes, dokumentacionin e përcaktuar në pikat 1, 2, 3 të këtij udhëzimi, si dhe propozon masën e ndihmës së menjëhershme financiare.
8. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në DPESHM, në Ministrinë e Mbrojtjes, pasi bën verifikimet e duhura brenda një afati kohor prej 5 ditë pune, e përcjell dokumentacionin te shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ose ia kthen komandës apo drejtorisë, nëse ka mangësi në dokumentet e paraqitura.
9. Inspektorati Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura bën vlerësimin e përputhshmërisë së diagnozës me sëmundjet e përcaktuara në këtë udhëzim sipas grupeve të sëmundjeve.
10. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura i propozon ministrit të Mbrojtjes dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare.
11. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në DPESHM ndjek procedurat dhe, brenda një afati kohor prej 5 ditë pune, bën gati praktikën për miratim te ministri i Mbrojtjes.
12. Udhëzimi nr. 10, datë 11.10.2019, i ministrit të Mbrojtjes, "Për procedurat e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, shfuqizohet.
13. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Forcave të Armatosura.
14. Ndjezin zbatimin e këtij udhëzimi shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



Formulari nr. 1

Reparti Ushtarak nr. \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_

## KËRKESË

**Lënda:** Për dhënie ndihme të menjëhershme financiare, në rast sëmundjeje të rëndë e të gjatë.

Drejtuar: \_\_\_\_\_

Unë, i quajturi \_\_\_\_\_, ushtarak aktiv, me gradën \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_, paraqes kërkesën time për t'u trajtuar me ndihmë të menjëhershme financiare, sipas ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, për shkak se:  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Bashkëlidhur kërkesës paraqes dokumentacionin e kërkuar:

1. fletëdalje/fletëpërmbledhje e daljes/epikrizë dalje e institucionit shëndetësor ku është trajtuar, i firmosur nga mjeku kurues, shefi i shërbimit, të ketë vulën e institucionit dhe të jetë i përkthyer dhe i noterizuar në rastet e trajtimit jashtë vendit;
2. vërtetim i shërbimit të statistikës të institucionit shëndetësor ku është trajtuar, që konfirmon shtrimin dhe kohëzgjatjen e qëndrimit në spital;
3. relacion mjekësor nga mjeku i familjes në qendrën shëndetësore ku ndiqet që konfirmon sëmundjen sipas kartelës shëndetësore, i firmosur nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist që e ndjek. Ky relacion të ketë vulën e institucionit;
4. certifikatë e gjendjes familjare në rast të sëmundjes së një pjesëtari të familjes në ngarkim të tij;
5. fotokopje e kartës së identitetit.

Ju faleminderit!

## KËRKUESI

---

Formulari nr. 2

Reparti Ushtarak nr. \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_

## KËRKESË

**Lënda:** Për dhënie ndihme të menjëherëshme financiare, në rast vdekje.

**Drejtuar:** \_\_\_\_\_

Unë, i quajturi \_\_\_\_\_, ushtarak aktiv,  
Unë, i quajturi \_\_\_\_\_, familjar i ushtarakut \_\_\_\_\_,  
me gradë \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_,  
paraqes kërkесën time për t'u trajtuar me ndihmë të menjëherëshme financiare, sipas ligjit nr.  
9210 datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së  
Shqipërisë", i ndryshuar, për shkak të vdekjes së \_\_\_\_\_.

Bashkëlidhur kërkësës paraqes dokumentacionin e kërkuar:

1. certifikatë e gjendjes familjare në momentin e ndodhjes së ngjarjes;
2. certifikatë vdekje;
3. certifikatë e gjendjes familjare pas vdekjes;
4. fotokopje e kartës së identitetit.

Ju faleminderit!

## KËRKUESI

---

Formulari nr. 3

Reparti Ushtarak nr. \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_

### KËRKESË

**Lënda:** Për dhënie ndihme të menjëhershme financiare, në rast të dëmtime të mëdha të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore.

**Drejtuar:** \_\_\_\_\_

Unë, i quajturi \_\_\_\_\_, ushtarak aktiv, me gradën \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_, paraqes kërkesën time për t'u trajtuar me ndihmë të menjëhershme financiare, sipas nenit 30, të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkak se:  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Bashkëlidhur kérkesës paraqes dokumentacionin e kérkuar:

1. certifikatë pronësie, kontratë porosie, dëshmi legalizimi ose çdo dokument tjetër provues që vërteton të drejta reale pronësie mbi pronën e dëmtuar;
2. procesverbal ose aktkonstatimi nga organet e qeverisjes qendrore ose vendore, të cilat kanë kompetencë sipas ligjit për konstatimin e gjendjes;
3. preventivat ose vërtetimet e dëmeve nga ana ndërtimore e pronës së ushtarakut hartuar nga organet e qeverisjes qendrore, vendore ose këshilli i qarkut ku ka ndodhur dëmi.”
4. aktekspertizë nga PMNZSH-ja, në raste zjarri;
5. certifikatë e gjendjes familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë natyrore;
6. fotokopje e kartës identitetit.

Ju faleminderit!

### KËRKUESI